



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА  
РЕПУБЛИКА Е МАQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_ г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 12/19), Neni 40 paragrafi 2 i Rregullores së punës për punën e Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar ndaj lëndës së formuar pas denoncimit të parashtruar, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme KSHPK), në vazhdimin e parë të seancës së 60-të, të mbajtur më 31.01.2022, miratoi si në vijim.

#### VENDIM

Denoncimi i regjistruar me numër 09-3389 / 1 nga 30.09.2020 , kundër -----, profesor i ----- më ----- , **REFUZOHET.**

KSHPK-ja konstatoi se në përputhje me Ligjin për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit nuk ka elemente për veprim kompetent në rastin në fjalë sepse nuk është konstatuar shkelje e dispozitave të të njëjtit ligj.

Lënda me numër 09-3389/1 të datës 30.09.2020 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së, në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimarrjes.

#### Arsyetim

Nga një parashtrues i njohur, më datë 30.09.2020, është dorëzuar denoncim kundër -----, profesor i ----- i ----- dhe është formuar lënda 09-3389/1 nga 14.04.2021.

Në denoncim parashtruesi thekson se personi ----- në të njëjtën kohë është edhe udhëheqës i studimeve të doktoratës në ----- dhe anëtar i bordit për -----, duke pasur parasysh se kjo është një gjendje e konfliktit të interesit.

Pas shqyrtimit të pretendimeve të lëndës, KSHPK-ja konstaton se në këtë rast nuk mund të iniciohet procedurë për konstatimin e gjendjes së konfliktit të interesit në pajtim me nenin 76 paragrafi 1 të LPKKI, gjegjësisht nuk ka ndalesë në të njëjtin ligj për situatën e mësipërme.

Në bazë të lartpërmendurës, KSHPK-ja vendosi si në dispozitën e këtij vendimi.

Përgatiti: S.M, bashkëpunëtor i lartë  
E kontrolluar nga: K.Z., Udhëheqëse  
Miratoi: G.T, anëtar i KSHPK-së

КОМИСИОНИ ШТЕТЁРОР  
ПЁР PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT  
KRYETAR,  
Biljana Ivanovska

